



Pranimi / Dorëzimi Punësi / Produkti Receipt / Delivery	02-08-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Pr. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRINSHICK	4462/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.613/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.613/2022 të datës 12.07.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër:21479 të U.D Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës i datës 12.07.2022, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa A.nr.613/2022 e datës 12.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër:21479 i U.D Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore si dhe Vendimi Kryetarit të Komunës së Kamenicës i datës 05.07.2022 me numër:20828.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Kamenicës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, ndërsa ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit të datës 30.07.2018.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsy et im

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Komunën e Kamenicës, në pozitën: "Udhëheqës i Sektorit për Inspektime në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektorat", është transferuar përkohësisht në pozitën "Udhëheqës i Arkivës pranë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit" përmes vendimit të datës 05.07.2022 të nxjerrë nga kryetari i Komunës së Kamenicës dhe pastaj përmes Vendimit të datës 12.07.2022 të nxjerrë nga Ushtruesi i Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ankuesi është transferuar përkohësisht në të njëjtën vend pune për periudhën kohore gjashtë (6) mujore.

Ankuesi kundër Vendimit të datës 05.07.2022 të nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Kamenicës, me datë 12.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është i kundërligjshme pasi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe po ashtu me datë 13.07.2022 ka bërë plotësimin e ankesës së datës 12.07.2022 pasi që ankuesi e ka pranuar edhe një Vendim të datës 12.07.2022 të nxjerrë nga Ushtruesi i Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ankuesi është transferuar përkohësisht në të njëjtën vend pune për periudhën kohore gjashtë (6) mujore me pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është i kundërligjshme pasi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Kamenicës. Këshilli, me datë 27.07.2022 me numër protokoll 4341/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 12.07.2022, me numër protokoll 4039/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës të datës 13.07.2022 me numër protokoll 4065/2022; Vendimit me numër:21479 të U.D Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës i datës 12.07.2022; Vendimin e kryetarit të Komunës së Kamenicës i datës 05.07.2022 me numër:20828; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.07.2022; Përgjigje në kërkesë e pranuar në Këshill me datë 27.07.2022; Akt emërimit e ankuesit i datës 30.07.2018 me numër:23114; Konkursin e datës 25.06.2018; E-mailin e datës 30.06.2022 të shefit të kabinetit të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; E-mailin e datës 04.07.2022 dërguar nga për Shkresën e mjekut e evidentuar me shënjën:18586 për hapjen e pushimit mjekësor nga ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, SEPSE:

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Aktit të Emërimit më numër:23114 të datës 30.07.2018 i llojit të emërimit: I karrierës/pa afat është i punësuar në Komunën e Kamenicës, në pozitën: "Udhëheqës i Sektorit për Inspektime në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektorat",

ndërsa fillimisht i njëjti është transferuar përkohësisht në pozitën “Udhëheqës i Arkivës pranë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit” përmes vendimit të datës 05.07.2022 të nxjerrë nga kryetari i Komunës së Kamenicës dhe pastaj përmes Vendimit të datës 12.07.2022 të nxjerrë nga Ushtruesi i Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ankuesi është transferuar përkohësisht në të njëjtën vend pune për periudhën kohore gjashtë (6) mujore.

Kolegji i Këshillit me qëllim të vlerësimit të drejtë të gjendjes faktike në kuptim të respektimit të drejtave të nëpunësve civil të cilëve u garantohen me ligjin material referuar PJESA III TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ZYRTARËVE PUBLIKË NËNKAPITULLI 1 TË DREJTAT E ZYRTARIT PUBLIK të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pavarësisht se Njësia e Burimeve Njerëzore pretendon se e ka shfuqizuar vendimin e Kryetarit të Komunës të datës 05.07.2022, Kolegji i Këshillit vendimin në fjalë e ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë, respektimit të parimeve në shërbimin civil dhe vlerësimit të cenimit eventual të të drejtave të nëpunësve civil të garantuara me ligjin material që rregullon Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës

Kolegji i Këshillit gjatë analizimit dhe shqyrtimit të përmbajtjes së vendimit të Kryetarit të Komunës së Kamenicës i nxjerr me datë 05.07.2022 ka gjetur se i njëjti është nxjerrë sipas kërkesë së datës 30.06.2022 të zyrtarit i cili e ka pozitën e shefit të kabinetit të kryetarit të Komunës së Kamenicës me arsyetimin se, *citoj përmbajtjen e e-mailit: “Ju lutem të transferohet shefi i inspektoratit në pozitën tek arkiva, sepse i njëjti nuk është bashkëpunues dhe me qasje dhe standart të dyfishtë dhe mos respektim të kohës”,* ndërsa zyrtari Zotrim Kastrati me datë 04.07.2022 i përgjigjet të njëjtit me arsyetimin se, *citoj: “Transferi i kërkuar nga ju mund të bëhet nga zyrtari Kryesor Administrativ, i cili i ka të gjitha kompetencat për marrjen e një vendimi të tillë”,* andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se Kryearti i Komunës së Kamenicës me rastin e transferimit të ankuesit ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Çdo institucion siguron një ambient të sigurt e të përshtatshëm pune për mbrojtjen e integritetit fizik, moral dhe të dinjitetit të zyrtarit”,* pasi që arsyetimi i dhënë në vendimin e kontestuar është në kundërshtim të plotë me vetë natyrën e transferimit dhe parakushtet të cilat duhet të plotësohen me qëllim të transferimit siç përcaktohet me nenin 52 të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ngase Kryetari i Komunës së Kamenicës duhet ta ketë pasur parasysh faktin se stafi politik të cilët i përgjigjen ekskluzivisht kryetarit dhe janë nëpunës të kabinetit, në rastin konkret shefi i kabinetit nuk ka asnjë të drejtë të dhënies së urdhrave apo vlerësimit dhe gjykimin përfundimtar mbi sjelljet e pretenduara të nëpunësve civil, pasi që në rastin konkret i njëjti as nuk është udhëheqës i drejtpërdrejt i ankuesit, dhe as nuk e ka mandatin dhe funksionin e Komisionit Disiplinor për të ardhur deri të përfundimi i gjykuar sipas e-mailit të datës 30.06.2022, respektivisht veprimet e tilla janë të ndaluara edhe me nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna ku përcaktohet se: *“Zyrtarët e emëruar në zyrën e Kryetarit, Nënkryetarit dhe Kryesuesit, nuk ushtrojnë asnjë autoritet mbi shërbyesit civil apo zyrtarët e tjerë në administratën e komunës”,* andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit në mbështetje nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme,”* konstaton se vendimi i kryetarit të Komunës së Kamenicës i datës 05.07.2022 është në kundërshtim me ligjin material dhe

diskrecioni i përdoruar apo e drejta e ushtruar për të transferuar stafin civil respektivisht ankuesin brenda institucionit nga pozita "Udhëheqës i Sektorit për Inspektime në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektorat", në pozitën "Udhëheqës i Arkivës pranë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit" është përcjelle me shkelje procedurale dhe shkelje të parimeve në shërbimin civil të përcaktuar me nenin 7 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe si i tillë, Vendimi i kryetarit të Komunës së Kamenicës i datës 05.07.2022 është i paligjshëm dhe shfuqizohet sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka gjetur se Ushtruese i Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 12.07.2022, ka nxjerrë vendimin me numër:21479 ku sipas pikës 1 të dispozitivit ankuesin e ka transferuar përkohësisht nga pozita "Udhëheqës i Sektorit për Inspektime në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektorat", në pozitën "Udhëheqës i Arkivës pranë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit" për periudhën prej 6 muajsh nga data 12.07.2022 deri me datë 12.01.2023, ndërsa sipas pikës 4 të dispozitivit ka shfuqizuar vendimin paraprak të Kryetarit të Komunës të datës 05.07.2022.

Kolegji i Këshillit e vë në vëmendje Ushtruesin e Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore se në kuptim të nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: "Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj", vendimin e datës 05.07.2022 mund të shfuqizojë vetëm autoriteti i cili e ka nxjerrë aktin sipas detyrës zyrtare respektivisht asnjë zyrtar tjetër brenda Komunës së Kamenicës nuk ka të drejtë ligjore të shfuqizojë vendimet e Kryetarit të Komunës ngase nuk e kanë statusin e organeve publike sipas përcaktimeve ligjore në rastin konkret, ndërsa aktin si të tillë mundet ta shfuqizojë vetë Kryetari i Komunës apo organi i tij mbikëqyrës sipas mandatit ligjor ose një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj, në rastin konkret Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil sipas mandatit ligjor lidhur me trajtimin e ankesave të nëpunësve civil.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, respektivisht ushtruesi i detyrës së Udhëheqësit të Njesisë, nxjerrjen e vendimit të datës 12.07.2022 për transferimin e ankuesit e ka arsyetuar në kërkesën e datës 09.07.2022 të Drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, citoj: "Duke marr parasysh faktin që udhëheqësi i arkivës ka dalur në pension dhe pozita është e lirë, ju lutem të transferoni një punëtor me qëllim që punët në sektorin e arkivës të përmbushen konform kërkesave dhe nevojave të sektorit, derisa të plotësohet në mënyrë të rregullt kjo pozitë", ndërsa Kolegji i Këshillit mbështetur në nenin 5 paragrafi 2 të rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: "....Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimin nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet" konstaton se arsyetimi i përdorur në këtë akt është i pamjaftueshëm pasi që nuk ka dhanë asnjë sqarim të mëtëjshëm se pozita të cilën e ushtron ankuesi dhe e cila do të mbetet e lirë për kohën sa ankuesi do të transferohet si do të ushtrohet dhe kush do të jetë përgjegjës për arritjen e objektivave të punës të përcaktuar sipas obligimeve ligjore të përcaktuara në Rregullore Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, shtuar faktin kësaj se për nga rëndësia e punës në aktiviteti zyrtar në Sektorin për Inspektime në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektorat, ka ndjeshmëri më të lartë sesa pozita në të cilën është vendosur të transferohet ankuesi, sikurse Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është dashur ta ketë parasysh faktin se pozita e cila ka mbetur e lirë ka mundur të

ushtrohet me zëvendësues, njëjtë siç është vepruar edhe me rastin e caktimit të zëvendësuesit të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport përmes kërkesës së datës 09.07.2022 drejtuar zyrtarëve të personelit dhe nuk ka kërkuar në mënyrë specifike që ankuesi të transferohet në pozitën e lirë, mirëpo Ushtruesi i Detyrës së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e ka transferuar ankuesin ngase për të njëjtin ishte një kërkesë e mëhershme nga shefi i kabinetit të Kryetarit të Komunës sipas e-mailit të datës 30.06.2022 për krejt të tjera arsye, por në të njëjtin vend/pozitë për të cilën ka kërkuar edhe Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe pasqyrimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se transferimi fillestar i ankuesit përmes kërkesës iniciuese të datës 30.06.2022 nga shefi i kabinetit të Kryetarit të Komunës dhe pastaj përsëritjes së kërkesës së datës 09.07.2022 nga Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për nevojën e transferimit me qëllim të plotësimit të vendit të lirë të punës, janë raste të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe s'mund të trajtohen ndaras në kuptim transferimit të përkohshëm të ankuesit për interes të institucionit, rrjedhimisht me rastin e inicimit të kërkesës për transferimin e ankuesit sipas e-mailit të datës 30.06.2022 të shefit të kabinetit të Kryetarit të Komunës, e deri te rasti i fundit të nxjerrjes së Vendimin me numër:21479 nga Ushtruesi i Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 12.07.2022 për transferimin të ankuesit është vepruar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*, andaj mbi këtë bazë si dhe të gjeturave të pasqyruara si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar në ligj, ndërsa vendimet e atakuara përmes ankesës së parashtruara në Këshilli me datë 12.07.2022 dhe plotësimit të saj me datë 13.07.2022, respektivisht Vendimi i datës 05.07.2022 i nxjerrë nga kryetari i Komunës së Kamenicës dhe Vendimi i datës 12.07.2022 të nxjerrë nga Ushtruesi i Detyrës së Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore janë vendime të kundërligjshme dhe si të tilla janë shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në shkesat e lëndës të ofruara nga institucioni punëdhënës ka gjetur se ankuesi ka hapur pushimin mjekësor sipas raportit mjekësor të datës 07.07.2022, ndërsa për këtë rast Kolegji i Këshilli vlerëson se është në të drejtën e nëpunësve civil të shfrytëzojnë të drejtën e garantuar me ligjin material dhe Ligjin e Punës lidhur me pushimin mjekësor sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara ligjore, mirëpo Kolegji i Këshillit nuk mund të lëshohet në shqyrtim jashtë profesionit dhe mandatit ligjor me qëllim të konstatimit nëse veprimet e kundërligjshme të institucionit kanë ndërlidhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.613/2022**

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

